

# TRIBUNA SINDIKALE

Prill 2008

*Dhe drit e diturisë  
përpara do na shpjerë*



## KONFERENCE TREPALLESHE MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT TE PUNES NE SEKTORIN E ARSIMIT

Me iniciativen dhe interesimin e Ministrise se Punes, Qeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Ministrise se Arsimit dhe Shkences dhe Sindikatave Qendrore te Arsimit, FSASH e SPASH, me 27 mars 2008, u zhvillua ne Tirane Konferenca Trepaleshe "Mbi Zbatimin e Legjislacionit te Punes ne Sektorin e Arsimit".

Ne konference muaren pjese drejtoret e Drejtorive Arsimore Rajonale, kryetaret e seksioneve sindikale ne qarqe dhe nga qyteti i Tiranes, nga te dy sindikatat, si dhe punonjes e specialiste te sektoreve te mardhenieve te punes, te pagave, buxhetit dhe juriste nga te dy ministrive organizuese te kesaj veprimtarie. Moren pjese dhe pershendeten Konferencen Zv. Ministri i Punes, Qeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Z. Kastriot Sulko, dhe Zv. Ministri i Arsimit dhe Shkences, Z. Halit Shamata.

Punimet e Konferences u moderuan nga Drejtori i Drejtorise se Mardhenieve te Punes ne MPCSSHB, Z. Bujar Cani.

Ne emer te dy sindikatave te arsimit, FSASH e SPASH, Kryetari i FSASH, zoti Xhafer Dobrushki, mbajti prezantimin kryesor, ku beri nje analize reale te zbatimit te legjislacionit te punes ne arsim, sidomos ne kendveshtrimin e funksionimit te partneritetit social ne te gjitha nivelet, ne permiresimin e pagave dhe te sistemit te shperblimit, ne zbatimin drejt te kriterëve te punesimit, ndryshimit te vendit te punes dhe largimeve nga puna dhe te lirive e te drejtave sindikale. Ne vijim, kryetari i SPASH, Z. Bajram Kruja, foli ne lidhje me nevojën per nje konsultim te vazhdueshem ndermjet partnereve e vecanerisht, kur eshte fjala per miratimin e ligjeve e vendimeve te rendesishme qe kane te bejne me mardheniet e punes dhe sistemin

arsimor ne pergjithesi ne vendin tone.

Perfaqesuesja e Departamentit te Burimeve Njerezore ne Ministrine e Arsimit dhe Shkences, Eleni Çoka, dhe perfaqesuesi i Drejtorise se Mardhenieve te Punes ne Ministrine e Punes, Qeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Gramoz Xhangolli, mbajten prezantimet ne emer te ministrive perkatese.

Drejtores te Drejtorive Arsimore Rajonale si dhe drejtues te seksioneve sindikale diskutuan ne menyre konstruktive, duke u pergendruar sidomos tek zbatimi i Kontrates Kolektive ne fuqi deri ne dhjetor te vitit 2009, vecanerisht per ceshtjet qe kane te bejne me ruajtjen e vendit te punes, duke shmangur transferimet dhe levizjet e padrejta, largimet nga puna, ne kundershtrim me kriteret profesionale, respektimin e te drejtave sindikale, perfshire edhe grumbullimin e kuotave nepermjet borderose, si edhe ne lidhje me angazhimin e perbashket per reformimin dhe modernizimin e arsimit dhe eliminimin e punes se femijeve ne vendin tone.

Z. Bujar Cani, ne ndehyrjet e tij gjate seancave te kesaj Konference, mbeshteti hapat qe kane ndemarre e po ndemarrin sindikatat e arsimit dhe MASH per institucionalizimin e tryezes periodike te partneritetit social dhe shtrirjen e kesaj pervoje edhe ne ministrive dhe sindikatat e tjera te sektoreve, jo vetem buxhetore, por edhe prodhues e privat.

Te dy zevendes ministrat pjesemarres ne Konference, shprehen angazhimet e ministrive perkatese per nje bashkepunim dhe partneritet me te mire ne te ardhmen dhe per bashkrendimin e forcave, me synim permiresimin e metejshej te sistemit arsimor ne vendin tone.

Konkluzionet e Konferences do te shtrihen e diskutohen ne cdo qark me Zyrat Arsimore Rajonale dhe seksionet sindikale te retheve.

## PERMBAJTJA

- ✓ Konference Trepaleshe mbi zbatimin e legjislacionit te punes ne sektorin e arsimit 2
- ✓ Kerkesat dhe pergjegjesite e sindikatave te arsimit ne procesin e partneritetit social; arritje dhe probleme 3
- ✓ Me shume sherbime per mesuesit sindikaliste 6
- ✓ Te permiresohet me tej puna e sindikatave te arsimit me grate mesuese 9
- ✓ Kodi i Etikes i Mesuesit, (Draft) Java e Veprimeve Globale per Arsimin, (21-27 prill) 10
- ✓ Mbi reformen e sistemit te zhvillimit profesional te mesuesve 13
- ✓ Gezuar Lirine, Kosova Martire 14
- ✓ Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15

### Kopertina e pare:

Nga punimet e Konferences Trepaleshe mbi zbatimin e legjislacionit te punes ne sektorin e arsimit

### Kopertina e fundit:

Nga punimet e Tryezes mbi punen me grate mesuese ne sindikate

## TRIBUNA SINDIKALE Nr. 33, Periodike

Botim i FSASH dhe SPASH

Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV

ADRESA:

Rruga "Dora D'Istria", Pallati Perballe Fakultetit Juridik, Kati i 3-te, Tirane

Tel & Fax + 355 4 25 65 32

Celular: + 355 68 20 34 674,

+ 355 69 22 69 795, + 355 68 21 52 891

E-mail: fsash@abcom-al.com

Internet: www.fsash-spash.com

### Keshilli Botues:

Xhafer Dobrushki,

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor

## KERKESAT DHE PERGJEGJESITE E SINDIKATAVE TE ARSIMIT NE PROCESIN E PARTNERITETIT SOCIAL; ARRITJE DHE PROBLEME

Nga Fjala Hyrese ne emer te FSASH e SPASH, pergatitur nga Z. Xhafer Dborushi dhe Z. Bajram Kruja

Kryesite e te dy Sindikatave te Arsimit, FSASH dhe SPASH, nenshkruese te Kontrates Kolektive te nivelit te pare me Ministrin e Arsimit dhe Shkences, pershendesin ribajtjen e kesaj Konference tregaleshtrebi "Zotimin e Legjislacionit te punes ne sektorin e arsimit".

Gjykuar nga subjektet pjesemarrrese, nga shkalla e gjere dhe e larte e perfaqesimit te te tre paleve dhe neni te gjitha nga qellimi qe ne bashkerisht synojme te arrijme dhe qe eshte ngritja ne nje nivel te ri me te larte, me cilesor e me te efektshem te dialogut e partneritetit social, si tipar thellesor i shoqerive dhe sistemeve qeverisese demokratike, e ben kete Konference aktivitetin e pare te ketij lloji

Kontrata kolektive e Punes, e cila sipas nenit 11 te Kodit te Punes, vjen menjehere rnas Kodit te Punes dhe akteve te tij nenligjore.

Disa nga dispozitat e kesaj Kontrate per te cilat ne mendojme te diskutojme ne kete Konference jane:

Se pari, dispozitat qe lidhen me punesimin, ndryshimin e vendit te punes dhe largimet nga puna.

Morojtja e marredhenieve te punes eshte funksioni kryesor i cob sindikate.

Ne nenin 4, pika 3 te KK te Punes ne fuqi thuhet: "Kriteret per punesim qe prandhen nga te dy palet nenshkruese me kete Kontrate Kolektive, te cilat jane te rmbeshtetura ne dispozitat perkatese te

sindikatave, i cili ben perzgjedhjen" rmbeshtetur ne nivelin arsimor, kryerjen e studimeve ditene apo me korrespondence, noten mesatare, shkallen e kualifikimit dhe specializimet e rjdhura nga Ministria e Arsimit dhe Shkences, titujt dhe gradat shkencore, kohen e punes ne arsim larg vendbanimit, etj.

Pembajtja e kesaj dispozite te KK te Punes perben nje arritje te rëndësishme, "de jure" eshte shfaqje konkrete e vullnetit dhe vendosmerise se partnereve, Ministrise se Arsimit e Shkences dhe Sindikatave, per te siguruar cilesine e kontigjenteve qe vijne ne arsim, per te shmangur subjektivizmin dhe rjeaneshmerine, per t'i rnyllur shtigjet punesimit ne arsim te te paafteve, militantëve te cob force politike qe eshte ne qeverisje dhe per te shmangur korupsionin, qe vazhdon te jete shure i perfolur.

Po cfare problemesh dhe shqetsimesh kemi sot ne kete fushe? Po ndalimi ne dy prej tyre qe jane me te rprehta.

1 Mesuesit me shkolle te mesme pedagogjike dhe shkolle te tjera profesionale te profilit te mesuesise.

Kjo kategori mesuesish perben akoma nje rrase te rëndësishme ne arsim. Aktualisht numri i tyre eshte rreth 4.500 vete, nga rreth 36.000 mesues dhe edukatore kopshti ne gjithë arsimin parauniversitar.

Sipas KK te Punes, kjo kategori mesuesish ploteson kushtet per t'u punesuar ne arsimin parashkollor dhe ne ciklin e ulet te arsimit 9 vjecar. Ne nenin 4, pika 4, shkronja "b" te KK thuhet: "Mesuesit qe jane punesuar ose do te punesohen ne arsim, sipas kriterëve qe ka miratuar Ministri i Arsimit dhe Shkences ne Aktet Normative, ...", per arsimin parashkollor dhe per ciklin e ulet te shkolles 9 vjecare, te pakten diplomën e shkolles se mesme pedagogjike, ose te nje shkolle tjetere te profilizuar per mesesi, sic jane shkollet emesre te muzikes, artistike, te gjuheve te huaja dhe te fizikultures".

Mirëpo, sic dihet nga te gjithë ne, Ministri i Arsimit dhe Shkences, me synimin per te pemiresuar cilesine ne arsimin parauniversitar, per te hapur muge per



dhe te ketyre pamasave ne vendin tone.

Partneriteti social si tipar dhe tregues i nje demokracie funksionale, i nje shoqerie demokratike, rregullchet me ligj. Ligjet e shtetit tone, kryesisht Kodi i Punes i Republikës se Shqiperise (miratuar me Ligjin nr. 7961 date 12.7.1995, ndryshuar me Ligjin nr. 8085 date 13.3.1996 dhe me Ligjin nr. 9125 date 29.7.2003) eshte rmbeshtetur dhe pasqyron, ne pergjithesi mire, standardet bashkekohore te marredhenieve te punes e per rnydhim edhe te partneritetit social, standarde qe jane perfshire ne Konventat tharelore te Organizates Nderkombetare te Punes, ILO, qe jane ratifikuar nga vendi yne dhe qe sipas Kushtetutes kane fuqine e ligjit, pra jane te detyrueshme per zbatim.

Nje vend te rëndësishem ne marredheniet e punes edhe ne sektorin e arsimit, ze

Kodit te Punes dhe ne Konventat Nderkombetare te Punes, duhet te jene te harmonizuara me Aktet Normative qe miraton dhe rnydh Ministri i Arsimit dhe Shkences dhe nuk duhet te kete mos pajtim midis tyre". Nisur nga ky parim, ne kete nen jane specifikuar moshë per punesim, shkalla e arsimit dhe kualifikimit si kusht per t'u punesuar ne cob cikël dhe nivel te arsimit parauniversitar, rastet e zgjidhjes se marredhenieve te punes me ose pa arsye, etj. Vend te vecante zene ne Kontrate perparasite e kandidatëve qe kerkojne te punesohen ne arsim. Keshtu ne nenin 4, pika 13 thuhet: "Kur per nje vend pune kon kurojne 2 ose me shume kandidatura, puneshtesi, drejtori i DAR ose drejtori i ZA, krijojne nje komision te posacem me pjesemarrjen e perfaqesuesve te

Vijon në faqen 3

prurje te reja ne arsim miratoi Udhëzimin Nr. 29 datel 18. 09. 2006 per emrimet dhe levizjet e personelit mesimor dhe drejtues ne arsimin parauniversitar". Ne pikën 7 te ketij Udhëzimi, per kete kategori mesuesish, theksohet se ata qe jane te punesuar ne zonat rurale ruajne vendin e tyre te punes, ndersa kjo kategori mesuesish me emrim definitiv ne qytetet qender qarku dhe rrethi mund te shikohet mundesia e zendesimit gradual te tyre duke mbajtur parasysh rrethanat konkrete, vjetersine ne pune, kohen e daljes ne pension, etj.

Kjo pike e Udhëzimit u keqinterpretua dhe u perdor sidomos nga disa ZA per te ndemarre nje fushate kunder ketyre mesuesve, duke shkelur ne menyre flagrante dhe te ashpër dispozitat e KK te Runes. Tipik eshte rasti i ZA Rogradec, e cila palajmeroi dhe faktikisht pushoi nga puna 180 mesues, ose me shume se 23 perqind te te gjithë mesuesve te rrethit, perfshire edhe ata mesues me shkolle te mesre ne zonat rurale. Ky veprim krijoi nje shqetsim te jashtezakonshem ne mesen e sindikalisteve dhe vuri ne levizje sindikatat. Veprime te kesaj natyre, por ne perrasa me te vogla, u ndemmoren nga ZA Devoll, DAR Shkoder, DAR Elbasan e ndonje tjeter.

Me ZA Rogradec ne u angazhuan ne negociime te drejtperdrejta. Mbas shpjegimeve qe bere dhe argumentave qe sollan, u tha se kjo do te korrigjohet, por ne te vertete ne fund te gushtit 2007 largimi i mesuesve te paralajmruar u be fakt. Vetem ndarhyrja energjike e sindikatave prane Ministrat te Arsimit dhe Shkences, beri qe Ministria te ndarhyje per te sqaruar pikën 7 te Udhëzimit nr. 29 date 18.09.2006. Ne kete leter sqaruese, ndër te tjera thuhet: "...ne kuptimin e ketij Udhëzimi mesuesit e CU dhe edukatorët me diplome perkatese ne qytetet qender qarku e rrethi, (sepse per zonat rurale Udhëzimi eshte i qarte dhe i prerë), nuk do te largohen nga detyra, ndersa mesuesit e CU dhe edukatorët qe rezulojne me deftese pjekurie te shkolles pedagogjike do te konsiderohen pa arsim perkates dhe, meqenese nuk plotesojne kushtet per nivelin arsimor sipas ciklit, do te largohen ne menyre graduale, duke mbajtur parasysh ne cob rast arrijtet ne pune, menyren e arsimimit, (diten apo me korespondence), moshen e daljes ne pension, kerkesat per punesim," etj. Natyrisht qe, mbas ketij sqarimi, ZA Rogradec e uli numrin e mesuesve te pushuar, por prap se prap 27 prej tyre u pushuan duke shkelur kriteret qe cituan me sipër. Seksioni yne sindikal ne

Rogradec e coi ceshtjen ne Gjykate. Gjykata e Shkalles se Pare ne Rogradec ka marre vendim ne favor te 27 mesuesve duke i kthyer ne pune. Po kete qendrim po rriban edhe Gjykata e Apelit ne Korce, e cila, sipas informacioneve qe kemi, te gjitha rastet qe ka shqyrtuar ka lene ne fuqi vendimin e shkalles se pare.

Nuk do ta parashtrojmë me kaq hollësi kete shkelje, nese nuk do te kishim shqetsime te kesaj natyre edhe ne fillimet e ketij viti. Prandaj, propozimi i sindikatave eshte qe te dy palet, ne nivelin e pare, ta shqyrtojne perseri kete ceshtje me qellim qe t'u pritet muga qendrive dhe praktikave antiligjore, por edhe te garantohet punesimi ne arsim vetem per ata qe e meritojne, qe ecin ne ritmin e kohes, qe perqafojne dhe zbatojne kerkesat per nje arsim publik cilesor e te modernizuar.

Pothuaj gjate gjithë kohes qe kjo Kontrate po zbatohet nuk kemi raste qe kandidatët qe konkurojne per punesim t'i nenshtrohen konkurimit dhe perzgjedhjes, sic kerkon neni 4, pika 13 e KK te Runes.

2 Dispozitat qe kane te bejne me ndryshimin e vendit te punes.

Ne kete pike, Kontrata Kolektive e Runes eshte teper e qarte. Duke iu referuar standardeve bashkekohore qe pëmbajne Konventat Nderkonbetare te Runes, ne Kontrate theksohet se ndryshimi i vendit te punes behet si rregull me kerkesen e punemarresit, me mbeshtetjen e sindikates ku ai ben pjese dhe vetem me kusht qe te punesuarit t'i pemireshen kushtet e punes, te pages dhe te jeteses.

Tjeter kusht eshte se kerkesa per ndryshimin e vendit te punes i paraqitet punedhenesit jo me vone se data 15 maj te cob viti, ndersa punedhenesi eshte i detyruar t'i njoftojte pergjigjen 30 dite para fillimit te vitit shkollor.

Ndryshimi i vendit te punes me iniciativen e punedhenesit behet vetem si perjashtim, per raste te vecanta dhe per nevoja madhore ne arsim.

Punedhenesi nuk mund t'u ndryshojte vendin e punes te zgjedhurve ne krye te sindikates ne shkolle ose ne rang seksioni. Nuk behet fjale qe ndryshimi i vendit te punes te behet gjate vitit mesimor. Nese ka raste te tilla perjashtimore, per cob anetar te njerës sindikate apo tjetres, punedhenesi para se te beje transferimin duhet te marre me pare mendimin e sindikates qendrore ku eshte i anetaresuar mesuesi. (Neni 5, pika 8 e KK te Runes).

Ne te vertete, jo vetem keto 3 vitet e fundit, por edhe me pare, me gjithë presionin

e ushtuar nga sindikatat, nga punedhenesi ne nivelin e dyte, pothuaj asnje nga keto kerkesa ligjore nuk zbatohet. Eshte bere nje praktike shqetsuese, qe sapo largohet nje titullar ne DAR apo ZA dhe vjen nje tjetër, kemi pothuaj ne cob rreth nje furtune levizjesh ne radhet e mesuesve dhe te drejtuesve te shkolleve. Ndoshta kjo ndodh si shenje e ushtimit dhe vendosjes se autoritetit, por nuk llogariten pasojat. Nuk do te kishte kuptim dhe mendjone se nuk do te arrijne te gjejne zgjidhje vetem duke theksuar se keto qendime e veprime jane antiligjore. Problemi duhet pare me thelle. Nje veprim i tille ve ne pasiguri mesuesit dhe drejtuesit, ungjall atyre ndjehen e frikes, te te qnit te perkohshem, rritj e iniciativen, vetveprimin dhe spiritin krijues, pra, rriti te gjitha, demton procesin mesimor dhe cilesine e punes ne shkolle, shkon ne kahje te kundert me qellimet dhe objektivat e Strategjise dhe reformimit e modernizimit te arsimit.

Te te diskutojne sot te gjithë bashke per minimizimin dhe eliminimin e ketij fenomen.

Se dyti, sistemi i pagave dhe i shperblimeve.

Karakteristike pozitive e Kontrates Kolektive te Runes qe po analizojne eshte angazhimi i te dy partnereve, i MASH dhe sindikatave, per te rrdertuar dhe garantuar nje sistem pagash dhe shperblimesh qe vlereson me mire dhe me realisht figuren dhe punen e mesuesit. Kjo u be e mundur nga programi i Qeverise qe doli nga zgjedhjet e vitit 2005, e cila prantoi dhe po e rriban prantimin per dyfishimin e pagave te punonjesve te arsimit brenda mandatit 4 vjecar, gje qe koincidon me kohezgjatjen e kesaj kontrate kolektive.

Sindikatat e Arsimit, si FSASH ashtu edhe SPASH, kane qene dhe jane te palekundura ne vleresimin shume pozitiv te mitjes se pagave te mesuesve ne keto perrasa dhe jane te angazhuara me shume pergjegjesi qe pagat e rritura dhe sistemi i shperblimeve te shkojne ne funksion te qellimit per te cilin Qeveria i ka akorduar. KK e Runes, ne dispozitat perkatese synon qe sistemi i shperblimeve qe mundesohet nga Fondi i Vecante, te luaj nje rol te vertete motivues per ata punonjes te arsimit qe bejne pune me cilesore, qe konsumojne kohe dhe mjete per te rritur shkallen e kualifikimit te tyre, qe edukojne edhe me figuren e tyre, qe sakrifikojne per t'i ndihmuar famijet rre, ata me probleme ekonomike e sociale dhe dari tek famijet e ngujuar qe te mos shkeputen nga shkollla,

që të mos mbeten analfabete, t'u njohë dhe shpërblejë meritat atij brezi që ia kushtoi jetën arsimit të brezave të rinj, që përdorimi i këtyre fondëve të jetë transparent. Për këtë arsye, në Kontrata parashikohet që në çdo fund viti mesimor DAR dhe ZA, në bashkëpunim me seksionet sindikale përkatëse, të shpallim mesuesit me të dalluar për çdo shkollë dhe në shkallë më e lartë, të cilët duhet të motivohen nga Fondi Vecante. Nuk i shërben aspak qëllimit për të cilin është dhënë ky fond praktika që u përdor në fund të vitit të kaluar, ku përveç 10 000 lekëshit që i jepet çdo mesuesi me vendim qeverie, si çdo punonjësi, pjesë e mbetur e FV u nda në pjesë të barabarta ose, me keq akoma, iu dha vetëm disa mesuesve sipas preferencave të drejtuesve të shkollave. Kjo praktike duhet të ndërpritet.

Po kështu, SPASH dhe FSASH janë kundër Udhëzimit të Ministrisë të Financave për kriteret e përdorimit të FV në ato pjesë ku thuhet se punëdhësi shpërblen deri në një pagë mujore mesuesit që dalin në pension. Në Kontratat Kolektive që është sot në fuqi, por edhe në 2 KK të rëpareshme, sindikatat kanë garantuar për mesuesit anëtarë të tyre që dalin në pension një shpërblim që jepet vetëm me autorizimin e Sindikatave Qendrore, natyrisht në konsultim me seksionet sindikale dhe punëdhënësin në nivelin e detyrës, deri në 2 paga mujore. Ky shpërblim ka me shumë se 6 vjet që funksionon, është në favor të punonjësit dhe, si i tillë, në kuptimin e pikës 3 të nenit 11 të Kodit të Punës, ai nuk mund të shfuqizohet nga asnjë akt ligjor apo nënligjor, jo me nga një udhëzimin ministri.

Se treti, në këto Kontrata Kolektive Sindikatat janë angazhuar dhe kanë marrë përgjegjësi që u takojnë në procesin e zbatimit të Strategjisë së Arsimit parauniversitar, për reformimin dhe modernizimin e sistemit arsimor dhe nritjen cilësore të tij.

Tashtë është e njohur se që prej disa vitesh, Sindikatat e Arsimit, nuk përballen me vetëm me kërkesa të natyrës ekonomike e sociale të anëtarëve që përfaqësojnë dhe të të gjithë mesuesve. Pas institucionalizimit të këtyre marrëdhënieve me kontrata kolektive të njëpasnjëshme dhe zgjidhjen ose venien në rrugë e zgjidhjes të kërkesave sociale ekonomike, atyre iu mundësua që të dalin në rolin e tyre me të plotë, të kenë një vizion me të gjere e me largpamës, t'i harmonizojnë e bashkërendojnë kërkesat sociale

ekonomike me angazhimin për forcimin dhe nritjen cilësore të sistemit arsimor, të reformimit dhe modernizimit të tij.

Është kjo arsyeja që prej me shumë se 6 vjetësh FSASH dhe SPASH bëjnë një punë sistematike, të programuar, duke venë në levizje potencialin e madh të anëtarëve të tyre në një problem jetik për shoqërinë dhe të ardhmen e saj, sic është parandalimi dhe eliminimi i punës së fëmijëve. Ky fenomen është i lidhur ngushtë me braktisjen e shkollës, me punën e fëmijëve në rrugë. Me rëmbështetjen e EI, me ndihmën e pakursyer të Sindikatave Holandeze të Arsimit, AOb, dhe të Konfederatës ku ajo ben pjesë, FNV, me bashkëpunimin produktiv me Programin Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve, IPEC, sindikatat tona kanë trajnuar qindra mesues, kanë krijuar kapacitetet e nevojshme dhe përvojën që ka bërë të mundur, jo vetëm sensibilizimin e masës së mesuesve, nxënësve e prindërve, por edhe ka mundësuar kthimin në shkollë të dhjetra e dhjetra nxënësve që e kishin braktisur atë dhe ka nxjerrë nga rrëziku i braktisjes qindra të tjerë. Nuk u ben ndër vetëm sindikatave fakti që puna dhe përvoja e FSASH dhe SPASH për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve sot është nga nga me të vlerësuarat në Europë dhe pikë referimi për sindikatat e vendeve fqinjë të Ballkanit e me gjere.

Në KK të Punës në, se bashku me MASH, kemi marrë zotim të përbashkët dhe detyrime reciproke ndaj njëri-tjetrit për të mbështetur e fuqizuar këto veprimtari. Shembujt e bashkëpunimit që kemi vendosur me DAR të Tiranës, Fierit, Korçës, Shkodrës, Elbasanit, etj. janë një garanci e mirë për suksesin e këtij aksioni.

Me rëndësi të vecante është puna që bëjnë sindikatat qendrore për nritjen e aftësive profesionale të mesuesve. Në këto funksion janë bërë disa botime cilësore. Midis tyre është Manuali "Mësimdhënia dhe të nxëniti në edukimin joformal", që përben një ndihmë të kualifikuar për nritjen e efektive të edukativ të orëve ekstra kurrikulare. Për zotërimin dhe përcorbimin e këtij Manuali në kemi trajnuar deri tani mësh 140 mesues në qarqet Fier- Vlorë, Korçë, Elbasan, Sarandë e Tiranë në seminare 3 ditore me specialiste të ILO-IPEC dhe Institutit të Këmbës të mjeteve financiare të përballuara nga sindikatat. Ky kontigjent mesuesish të trajnuar i është bërë i njohur Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës dhe lista e tyre do të vihet në dispozicionin tuaj për të përdorur sipas nevojave që kemi.

Duhet theksuar se edhe në seminarët, tryezat, anketat dhe intervistat që kanë organizuar sindikatat për nritjen e kapaciteteve të tyre drejtuese dhe funksionale, për gjallërimin e veprimtarisë së grave dhe të mesuesve të rinj në sindikate, krahas formimit sindikal, vend kryesor kanë zënë edhe temat profesionale për aftësimin e mesuesve me kërkesat që shtrën Strategjia e Arsimit parauniversitar dhe në përvojën e vendeve të Europës Perëndimore si Holanda, Italia, Franca, Gjermania, Austria, etj.

Se katërti, dhe se fundi, në Kontratat Kolektive janë garantuar të drejtat dhe liritë sindikale sipas standardeve bashkëkohore.

Mbështetur edhe në nenin 181 të Kodit të Punës, në nenin 13 të KK, punëdhënësi ka garantuar kohën e nevojshme për t'u marrë me veprimtari sindikale për drejtuesit sindikaliste në rang seksioni sindikal, u është ndaluar punëdhënësve në nivel të detyrës që të transferojnë ose largojnë nga puna drejtuesit sindikal pa miratimin e sindikates ku ata janë zgjedhur, përballë shpenzimit të kryetarëve të seksioneve për pjesëmarrjen në 4 mbledhje në vit të Këshillave Drejtuese të Sindikatave Qendrore. Po kështu, drejtuesve sindikal në shkallë më e lartë dhe shkollë u garantohet leje e pagueshme për të marrë pjesë në veprimtaritë sindikale lokale, kombëtare e ndërkombëtare aq kohë sa zgjat aktiviteti, me kusht që kërkesa t'i paraqitet DAR ose ZA 5 ditë para aktivitetit.

Në Kontrata është parashikuar që, në bazë të listave të rregullta të anëtarëve të secilës sindikate, ku mesuesit deklarohen vullnetin e tyre për t'u anëtarësuar në njerën sindikate ose në tjetrën dhe autorizojnë në mënyrë të shprehur që kuotizimi i anëtarëve t'u zbritet nga paga, sic parashikohet edhe në nenin 117, pikë 2 e Kodit të Punës, Qendrat Ekonomike të DAR ose ZA, me kërkesën e Sindikatave Qendrore, duhet të bëjnë ndalësën dhe xhirimin në llogaritë e sindikates, si rregull, një herë në 6 maj.

FSASH dhe SPASH do të rrisin kërkesat ndaj vetvetes në të gjitha nivelet për të qenë partnerë seriozë, reale dhe të përgjegjshme, për të bërë që të funksionojnë në mënyrë periodike 2-3 mujore tryezat e dialogut midis nesh në të dy nivelet, në mënyrë që të gjejnë zgjidhje problemat dhe kërkesat e secilës pale në funksion të qëllimit tonë të përbashkët, reformimit dhe modernizimit të sistemit të arsimit në vendin tonë.

# ME SHUME SHERBIME PER MESUESIT SINDIKALISTE

Nga Tryeza me pjesemarrjen e drejtuesve sindikaliste te qarqeve e rretheve

Ne Tirane, me pjesemarrjen e 26 pjesemarrjesve nga 17 rrethe, 11 prej te cileve nga radhet e grave sindikaliste, si edhe ne prezence te Zv. Presidentit te Sindikates se Arsimit te Holandes, AOb, Ton Rolvink dhe ekspertit te kesaj sindikate Gijs van Dijk, dhe te dy kryetareve te sindikatave tona te arsimit, Xhafer Dobrushi e Bajran Kruja, u zhvillua Tryeza e rendesishme rreth mundesine e zgjerimit te sherbimeve per anetaret, si detyrueshmeri per mritjen e numrit te tyre dhe fuqizimin e metejshtes te sindikatave tona te arsimit.

anetareve, si edhe disa nga sherbimet kryesore qe ato synojne te sigurojne ne te ardhmen e afert e ne perspektive, vecanerisht nepermjet permi-resimit te punes per zbatimin e kontrates kolektive dhe zgjerimit te bashkepunimit me institucione te tjera, sidomos ato te sistemit te sigurimeve shoqerore, bankave, agjensive turistike etj.

Ne vijim, zoti Ton Rolvink beri nje paraqitje te pervojës se sindikates se arsimit te Holandes, AOb, duke permendur, para se gjithash, punen e organizuar per mritjen e pagave dhe permi-resimin e

Shembuj konkrete u paraqiten ne Tryezen nga eksperti i AOb, zoti Gijs van Dijk, i cili theksoi se insistimi i sindikatave per me shume sherbime per anetaret, nepermjet burimeve te veta, por sidomos nepermjet bashkepunimeve me institucione te tjera, eshte baza e forcimit te tyre dhe parakusht vendimtar per zgjerimin e anetaresise dhe fuqizimin ekonomiko-financiar te tyre.

Nderhyrje konkrete u bene edhe nga Kryetari i SPASH-it, zoti Bajran Kruja, i cili, krahas te tjerave, nenvizoi domosdoshmerine e forcimit te bashkepunimit me Ministrine e Arsimit dhe Shkences, sidomos per te zbatuar disa nene te vecanta te Kontrates Kolektive te Punes, te cilat kerkojne vendime Qeverie, si edhe nje angazhim me te mire te drejtuesve sindikaliste ne qarqe e rrethe per realizimin e marrveshjeve rajonale me interes per mesuesit anetare te sindikatave.

Pjesemarrjesit ne Tryeze vleresuan punen e bere deri tani nga te dyja sindikatat e arsimit, sidomos nepermjet Kontrates Kolektive te Punes, por nderkohe ata kerkuan me shume angazhim dhe plane konkrete per zgjerimin e sherbimeve vetem per anetaret, nbase kjo eshte menyra me e mire per t'i tehqur te gjitha mesuesit ne radhet e sindikatave.

Disa prej tyre, si Aleks Dushi e Isa Reka, (Shkoder), Shpetim Sino e Lavdosh Llanaj, (Fier), Rustem Jahaj, (Dures), Bukuroshe Shabani, (Elbasan), Istref Haxhillari, (Pogradec), Ismet Spahiu, (Diber), Luan Zonja, (Lushnje), etj, e vune theksin tek veprimet konkrete te organeve qendrore te sindikatave per sigurine e vendit te punes dhe shmangien e pushimeve e transferimeve te parotivuar nga puna, fokusimi gjithnje e me i madh tek problemet e kualifikimit profesional te mesuesve, hartimi dhe miratimi i Statusit te Mesuesit, motivimi me i mire i mesuesve per pune shites dhe rezultate te mira, si edhe tek zbatimi i pervojës holandeze dhe asaj te vendeve te tjera te paraqitura ne kete Tryeze. Ata vleresuan organizimin e Tryezes dhe angazhimin e organeve qendrore te te dy sindikatave per t'iu pergjigjur kerkesave dhe interesave te mesuesve anetare te tyre.



Tryeza u parapri nga nje pune e gjithaneshme pergatitore, perfshire konsultime me kryesite respektive te FSASH e SPASH dhe me disa nga drejtuesit lokale te seciles sindikate, pergatitjen e nje draft dokumenti si baze per diskutim, kontaktet me disa sindikata te tjera simotra ne rajon e me gjere, (Sloveni, Itali, Gjermani etj), per te njohur me mire pervojën pozitive qe ekziston dhe konsultimet me Ministrine e Arsimit dhe Shkences per mundesine e zgjerimit te bashkepunimit ne kete fushë.

Ne emer te dy sindikatave tona te arsimit, zoti Xhafer Dobrushi, beri nje paraqitje te situates aktuale ne lidhje me kete problem, duke evidentuar sherbimet kryesore qe sindikatat u ofrojne aktualisht

kushteve te punes se mesuesve e punonjesve te tjere te arsimit. Me tej, ai u ndale sidomos tek sherbimet qe AOb u ofron vetem anetareve, duke evidentuar disa prej tyre, si ndima ligjore, nepermjet sqarimeve ne telefon, takimeve te drejtperdrejta, perfaqesimit ne procese gjyqesore tej, si edhe marrveshjet me kompani sigurimesh shoqerore, banka e agjensit turistike per kushte favorizuese per mesuesit anetare te AOb, organizimin e kurseve te kualifikimit profesional dhe aktiviteteve te tjera me interes per anetaret, botimet e ndryshme me karakter profesional dhe me informacione per tregun e punes dhe proceduarit e punesimit, te cilat shpeshohen falas vetem per anetaret e sindikates etj.

Pas diskutimeve, nderhyrjeve te pjessanarëve e drejtuesve sindikaliste te pranishem dhe debateve konstruktive, u perpunua nje platforme per punen e FSASH e SPASH gjate ketij viti e ne vijim ne lidhje me kete ceshtje.

Kordinatori i projektit, Stavri Liko, vuri ne dukje rendesine e ndjekjes per zbatim te detyrave qe u percaktuan ne kete platforme, duke u rikujtuar pjessanarëve se nje tjetër tyreze eshte parashkuar te zhvillohet vitin e ardhshem, me synim per te analizuar punen qe do te behet dhe rezultatet konkrete qe do te arrihen gjate nje periudhe afersisht njevjecare dhe per te percaktuar objektiva te tjera ne perputhje me situaten dhe kerkesat e kohes.

Nje sesion i vecante i kesaj Tryeze iu kushtua ceshtjeve qe lidhen me procesin e filluar tashme per hartimin dhe miratimin e Kodit te Etikës per mesuesit, ku drejtuesit e FSASH e SPASH informuan pjessanarësit per punen e bere deri tani nga nje grup i posacem specialistesh dhe disa nga elementet kryesore te draftit qe eshte ne perfundim, ndersa koleget e AOb paraqiten pervojën holandeze ne kete fushë, duke u ndalur posacerisht tek

Karta e Miresjelljes qe eshte nje instrument ligjor shume efektiv i perdonur ne sistemin arsimor.

Pjessanarësit mirepritën informacionin se drafti i ketij Kodi do te botohet ne



numrin e ardhshem te Revistes "Tribuna Sindikale" dhe do te jete i hapur per mendime e propozime, te cilat do t'i paraqiten Grupit te Punes per t'u mbajtur parasysh ne variantin perfundimtar te ketij Kodi.

Ne emer te dy sindikatave tona te

arsimit, FSASH dhe SPASH, zoti Xhafer Dobrushki, falenderoi koleget nga sindikata e arsimit e Holandes, AOb, Zv/Presidentin e saj, Z. Ton Polvink dhe ekspertin Gijs van Dijk, per kontributin e tyre ne zhvillimin

e suksesshem dhe efektiv te kesaj Tryeze, si edhe, nepemjet tyre, falenderoi sindikatat holandeze FNV dhe AOb, per gjithcka ato kane bere dhe po bejne per te ndihmuar e fuqizuar sindikatat tona dhe per te modernizuar sistemin arsimor ne vendin tone.

## TE SIGUROJME ME SHUME SHERBIME PER MESUESIT SINDIKALISTE

Nga Fjala Hyrese, mbajtur, ne emer te FSASH e SPASH, nga zoti Xhafer Dobrushki

Bordet drejtuese te te dy sindikatave tona ne nivel qendror, por edhe me gjere, prej disa kohesh po diskutojne rreth temes se cfare sherbimesh te tjera duhet t'u ofrojne sindikatat e arsimit anetareve te tyre.

Ky diskutim nuk ka lindur rastesisht. Disa vite me pare, mund te thuhet qe kur u krijuan, Sindikatat e Arsimit, si FSASH ashtu dhe SPASH, ishin dhe vazhdojne te mbeten te angazhuara per zgjidhjen e kerkesave imediate ekonomike e sociale, sic ishin levizjet e njehura sindikale te viteve 1991, 1999, 2001, 2002 dhe 2004, por edhe negociimet e dialogu i argumentuar me Qeverine e MASH, per rritjen e pagave, per pagën e 13-te, per diferencimin ne page te mesuesve ne shkolle te mesme pedagogjike e shkollla te tjera profesionale ne krahasim me mesuesit me shkolle te mesme te pergjithshme ose te profilit joarsimor,

vendosjen e javes 5 diteshe te punes, shtimin e lejes se pagushme vjetore, etj. Me rendesi eshte perpunimi dhe perfshirja e kriterëve dhe standardeve te punesimit, te levizjeve e transferimeve dhe largimit nga puna ne Kontraten Kolektive te nivelit te pare, qe te pakten «de jure», i garanton dhe i mbron mesuesit nga qendrimet subjektivistë, haknarrëse, partiakë e sindikale, qe kane ndodhur dhe vazhdojne te ndodhin edhe st. Te gjitha keto kerkesa, te cilat kane qene te argumentuara, te drejta dhe te mundesime per t'u realizuar, me dialog ose me levizje sindikale, me greva apo manifestime nje oreshe, nje ditore apo njejavore, ne mjaft raste jane zgjidhur ne favor te sindikatave.

Kjo ka bere qe gjate viteve te veshtira te tranzicionit, nga viti ne vit pagat e mesuesve te sistemit parauniversitar, por edhe te te gjithë sistemit arsimor ne teresi,

te pemirosohen ndjeshem dhe te stabilizohen. Tani po behen perpjekje per te perpunuar kriterëve e norma qe te motivohen me mire mesuesit me te angazhuar dhe qe bejne pune cilesore.

Mirepo, eshte e njohur se nga kerkesat e drejta te sindikatave, nga zgjidhjet qe jane arritur ne favor te mesuesve, nuk kane perfituar vetem sindikalistet. Nga keto zgjidhje kane perfituar te gjithë mesuesit dhe punonjesit e arsimit qe nuk jane te anetarsuar ne asnjeren sindikate. Dhe nuk mund te ndodhte ndryshe, sepse nuk mund te beheshin as nuk mund te behen diferencime midis mesuesve, kur eshte fjala per te drejta qe jane universale, sic jane rritja e pagave, pemirosimi i kushteve te punes, koha e punes dhe e pushimit, etj.

Tipike eshte se kur disa nga kerkesat

Vijon nga faqja 7

ekonomike sociale që përmenden më lart janë zgjidhur me levizje sindikale, sidomos para 3-4 viteve, sindikatat i ka mbështetur masa e madhe e mesuesve dhe, natyrisht, kjo ka ndikuar në shkallën e plotësimin të kërkesave të parashtruara. Në këto momente janë verejtur edhe anetaresime të ndjeshme të mesuesve në sindikata, qoftë në njerën ose në tjetrën.

Por, gjatë këtyre pesë viteve të fundit, në jetën e të dy sindikatave tona nuk kanë ndodhur levizje të fuqishme sindikale në arsim, në kuptimin e grevave, manifestimeve apo demonstrimeve. Shumica e problemeve, sfidave me të cilat jemi ballafaquar, kërkesat e anetareve, janë zgjidhur e po zgjidhen nëpërmjet dialogut social, negociimeve pëthuhaj në të gjitha nivelet. Po t'i shtojmë kësaj edhe një angazhim të ndjeshëm të sindikatave të arsimit në veprimtarinë për reformimin dhe modernizimin e arsimit, në parandalimin dhe eliminimin e punës së famijëve etj., krijohet, ose me saktë është krijuar një opinion, sikur sindikatat e arsimit në vend kanë ndryshuar strategji, kanë hequr dorë nga levizja sindikale dhe po bashkëpunojnë me qeverinë apo punëdhënësin.

Ketu e ka burimin kryesor indiferentizmi i një mase të ndjeshme mesuesish ndaj sindikatave, hezitimi sidomos i mesuesve të rinjë, për t'u anetaresuar në sindikate, por edhe i mesuesve më stazh që nuk afrohen tek ne, që shprehën mosbesues.

Mosbesues ka edhe në radhët e sindikatave tona, të cilët jo rrallë, së bashku me mesuesit që nuk janë të anetaresuar, na pyesin: Cfare po bëni ju për ne?

Nga të gjitha ato që thame mund të arrijmë në një konkluzion të vertetë: Në kushtet e sotme zgjidhjet e kërkesave ekonomike e sociale që bëjnë sindikatat dhe që perfshijnë gjithë masën e mesuesve apo të punonjësve të arsimit, nuk janë të mjaftueshme për të ruajtur e forcuar lidhjet dhe besimin e mesuesve ndaj sindikatave të tyre, për të rritur interesimin e kësaj mase të madhe intelektuale, sidomos të mesuesve të rinjë, për t'u anetaresuar në sindikate.

Ky konkluzion i përgjithshëm ka bërë që sindikatat tona të fillojnë të mendojnë e veprojnë për t'u orientuar e për të gjetur

mundësi që t'u ofrojnë me shumë shërbime e mbrojtje, jo me gjithë mesuesve, por vetëm anetareve të tyre. Në, dhe shumë kolege sindikaliste në të gjitha nivelet, kanë filluar të ndjeshin këte si një nevojë, si një kërkesë të kthes, pa zgjidhjen e së cilës nuk do të mund t'i arrijmë objektivat tona për gjallërimin e levizjes sindikale në Shqipëri dhe mritjen e kapaciteteve të saj.

Për të shkuar më tej, është e nevojshme të evidentojmë atë përvojë që tashmë ekziston tek të dyja sindikatat tona, në lidhje me shërbimet e vecanta që ato u kanë ofruar dhe u ofrojnë anetareve të tyre.

Kështu, në Kontraten Kolektive të nivelit të parë, sidomos kur është fjala për marrëdhëniet e punës, thuhet shprehimisht se ato, sindikatat, ndërsa përpunojnë e perfshijnë në Kontrate norma e standarde për të gjithë statusin e të punësuarve në arsim, në praktike, rast pas rasti, ato mbrojnë në rast konfliktesh me punëdhënësin deri në gjykatë, vetëm anetaret e tyre.

Po kështu, në Kontraten Kolektive të nivelit të parë, si në këte ekzistuese, ashtu edhe në të kontratave para kësaj, pra prej rreth 7-8 vjetësh, mesuesit që dalin në pension perfitojnë deri 2 paga mujore. Ky shpërblim jepet vetëm nga titullaret e sindikatave qendrore me propozim të seksioneve sindikale në rrethë dhe vetëm për anetaret e sindikatave, pra vetëm për mesuesit sindikaliste.

Por, sic e thamë edhe më parë, në jemi të ndërgjegjshëm se këto që janë bërë si shërbime që sindikatat u ofrojnë vetëm anetareve të tyre, janë të pamjaftueshme. Para se të vinim në këte TËRYZE, në iu drejtuan disa sindikatave në Europë për të na dhënë përvojën e tyre në lidhje me shërbimet e vecanta që ata u ofrojnë vetëm sindikalisteve. Kemi marrë përgjigje nga FLC-CGIL në Itali, nga sindikata e arsimit të Sllovenisë, para disa kohësh kemi kontaktuar lidhur me këte çështje sindikaten e Maqedonise dhe me kryesorja është se sot këtu kemi edhe perfagesuesit e ndëruar të Sindikates Hollandeze të arsimit.

Nga veshtrimi i këtyre përvojave dhe vecanerisht i mundësive tona, une, në emër të të dy sindikatave tona, FSASH e SPASH, do të parashtrojë disa drejtime ku mund të përqendrohemi dhe së çfare

konkretisht mund t'u ofrojnë anetareve tane në të ardhmen.

1 Të gjithë mesuesit, një herë në vit, si rregull në fillim të vitit shkollor, janë të detyruar të bëjnë një vizitë mjeksore për të provuar se janë të afte nga ana shëndetsore. Për këte vizitë ata paguajnë 500 leke. Në do të fillojmë së shpejti negociimet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, që këte pagesë, vetëm për mesuesit sindikaliste, ta perballojë punëdhënësi.

2 Për rastet e kurimit të sëmundjeve të rënda, që kërkojnë kosto të larta, si brenda apo jashtë shtetit, për mesuesit sindikaliste masa e ndihmes të jete jo më pak se 20 përqind, në krahasim me çb mesues tjetër .VKM per Fondin e vecante nuk perfshine kurimet brenda vendit,

3 Për mesuesit anetare të sindikates, të cilët kanë famije që ndjekin studimet e larta në arsimin publik, kur të ardhurat e tyre për frymë në familje janë nën minimumin jetik, FSASH dhe SPASH të perballojnë çb vit 20 deri në 50 përqind të koston së shkollës së lartë.

4 Mesuesve anetare të sindikates, sipas nevojave dhe kërkesës së tyre, t'u ofrojmë kurse trajnimit profesional falas.

5 Me kërkesën e regjistruar të çb sindikalisti, FSASH dhe SPASH u jep falas revisten "Tribuna Sindikale".

6 SPASH dhe FSASH do të negociojnë me Raiffeisen Bank, për të nënshkruar një Marrëveshje që anetareve të sindikatave tona t'u mundësohet kredi për shtëpi ose kredi tjetër me përqindje më të ulët interesi së klientit e tjere. Sindikata perkatese mund të bëhet edhe garante për kredinë.

7 FSASH dhe SPASH do të ofrojnë për anetaret e tyre konsulence ligjore falas kryesisht për marrëdhëniet e punës, por edhe për nevoja të tjera dhe do t'i ndihmojnë anetaret e tyre për të formuluar kërkesë-padite. Për marrëdhëniet e punës do të këte edhe mbrojtje ligjore falas.

Konkluzionet e kësaj TËRYZE në lidhje me shërbimet që FSASH dhe SPASH do t'u ofrojnë anetareve të tyre do të diskutohen e miratohen në organet drejtuese të secilës sindikate dhe pastaj do të publikohen duke i afishuar në çb shkolle dhe në Revisten "Tribuna Sindikale".



## Te permiresohet me tej puna e sindikatave te arsimit me grate mesuese

Nga Tryeza me pjesemarrjen e perfaqesueseve te Komiteteve te Grave te FSASH/SPASH

Tryeza e Rrumbullakte mbi pjesemarrjen e grave mesuese ne sindikate, organizuar ne Tirane, ne datat 28 dhe 29 mars, ishte faza pambyllese e anketimit te organizuar nga dy sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, ne kuadrin e zbatimit te Projektit me FMV/AOb, me synim per te njohur me mire gjendjen, per te bere nje analize te situates dhe per te percaktuar disa detyra te tjera konkrete ne procesin e realizimit te objektiveve te caktuara ne kete drejtim.

dhe nga ana e organeve drejtuese te dy sindikatave ne qender e ne rrethe, u rrobq nga afer e tere puna konkrete e tyre ne kontaktet me masen e grave ne keto shkolla.

Ne prezence te grave drejtuese lokale te ketyre rretheve, drejtueseve te 13 grupeve te punes, si edhe te disa grave drejtuese te komiteteve te grave te disa rretheve te tjera, ne Tyeze u bene te ditura konkluzionet qe dalin nga Anketimi, te cilat ishin rezultat i nje pune te madhe

- Cfare presin grate mesuese nga sindikatat dhe komitetet e grave dhe disa vleresime per anketimin dhe perdorimin e konkluzioneve ne punen e tyre ne te ardhmen.

Pjesemarrja aktive e ekspertes se AOb mbi problemet e rolit te sindikatave per punen me grate mesuese, Zonjes Claire Oostvriesland, pati nje ndikim te drejtperdrejte per nje pune efektive gjate dy diteve te Tyezes, duke perdorur gjeresisht metoden e punes ne grupe, duke diskutuar ne lidhje me konkluzionet per secilen prek ketyre problemeve dhe duke percaktuar prioritetet, edhe mbi bazen e pervojës se AOb.

Kryetaret e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushit dhe Bajram Kruja, moren pjese ne pjesen me te madhe te seancave, duke dhene nje kontribut te drejtperdrejte ne konkretizimin e problemeve qe kane dale nga konkluzionet e anketimit.

Angazhimi aktiv i shumices se grave pjesemarrrese ne punen ne grupe dhe ne raportime, si Rajmonda Leka, Mirela Kamriqi, Luiza Gjoka, Adelina Speredheja, Besije Mehmetaj, Elsa Peco, Flora Çarçani, etj, e beri kete Tyeze shume efektive, gje qe prenton per permiresime te ndjeshme ne punen me grate ne seksionet respektive te ketyre rretheve.

Programi i punes i diskutuar ne Tyeze, do te perpunohet me tej nga grupi i punes ne nivel qendror dhe do te ndiqet per zbatim nga Kryesite dhe Komitetet e Grave te te dy sindikatave, duke perfshire, gjithashtu, edhe seksionet e rretheve te tjera, perfaqesueset e te cilave nuk paten mundesi te mermin pjese ne kete Tyeze.

Anketimi u konsiderua si nje eksperience e re per grate mesuese, por ne te njejten kohe, ai krijoi edhe nje opinion te mire tek te gjitha mesueset ne shkollat, duke treguar qartazi se sindikatat, jo vetem po mbrojne interesat social ekonomike te anetareve te tyre punonjës te ketij sektori te rëndësishëm, por ne te njejten kohe, ato, ne bashkëpunim edhe ne instancat e tjera te arsimit, po luajne nje rol te rëndësishëm ne reformimin dhe modernizimin e sistemit arsimor ne vendin tone.



Anketimi u realizua ne 65 shkolla 9-vjecare e te mesme nga 9 rrethe, duke synuar qe te perqendroheshim ne rrethe te medha e me peshe ne levizjen tone sindikale, si Tirana Qytet e Rreth, Durrësi, Elbasani, Vlora, Fieri, Shkoder, Korca etj. Per kete qellim u organizuan 13 grupe, dhe u mobilizuan 65 drejtuese dhe aktiviste te te dyja sindikatave, te cilat gjate nje periudhe kohe prej me shume se dy muajesh kontaktuan, intervistuan, por edhe punuan per sqarime e angazhime te tjera, me shume se 650 gra mesuese, anetare ose jo te ketyre sindikatave.

I tere ky angazhim dhe keto aktivitete u paraparinë nga nje pune e gjithaneshme parapergatitore. U bene konsulta me dy kryesite dhe komitetet e grave ne nivel qendror, mbi bazen e konkluzioneve te te cilave u hartua pyetori i anketimit, u bene trainime te drejtuesve te 13 grupeve, u be perzgjedhja dhe sqarimi i 65 anketueseve

perpunese te bere nga grupi i punes ne nivel qendror, me pjesemarrjen e drejtuesve Fatbardha Keço, Bukuroshe Shabani, Lunturi Mataj, Albina Pepo, te cilat punuan me perkushtim, jo vetem gjate anketimit, por edhe gjate periudhes se perpunimit te te dhenave qe rezultuan nga anketimi.

Kater ishin ceshtjet me te rëndësishme qe u trajtuan ne keto Konkluzione:

- Rozita e grave ne sindikata dhe ne organet drejtuese te tyre dhe roli i komiteteve te grave dhe vete sindikatave per te permiresuar gjendjen aktuale,

- Mendimet e grave mesuese dhe atyre drejtuese lokale ne lidhje me ceshtjet qe kane te bejne me marçheniet e punes te grave mesuese,

- Mendimet e grave mesuese dhe atyre drejtuese lokale ne lidhje me problemet sociale dhe ato te organizimit te kohes se lire nga ana e sindikatave,

# KODI I ETIKES I MESUESIT

( Draft )

Me inisiativen e MASH dhe Fondacionit SOROS, me pjesëmarrjen e FSASH dhe SPASH, nje grup specialistesh po punon prej disa muajsh per hartimin e Kodit te Etikes te Mesuesit. Tani qe Grupi i ngarkuar ka perpunuar nje draft , Redaksia e Revistes " Tribuna Sindikale" vendosi ta botoje ate per t'u dhene mundesi sindikalisteve dhe gjithe mesuesve qe te bejne verejtjet, sugjerimet dhe plotesimet qe mendojne.

Rregullat e etikes ne marrëdhëniet  
mësues - nxënës

Mësuesit nuk i lejohet të:

- Ushtrrojë dhurë fizike, psikologjike, verbale, seksuale, etj;
- Diskriminojë për shkak të racës gjinisë, seksit, përkatësisë fetare, gjendjes sociale, etj;
- Fyejë e përdorë fjalor të papërshtatshëm me nxënësit e tij;
- Zhvillojë mësimë private me nxënësit e shkollës së vet;
- Pranojë dhurata e ryshfete nga nxënësit;
- Përdorë nxënësit për fushata elektorale apo promovionale;
- Diskutojë në nxënësit tema që janë të papërshtatshme dhe çënojnë formimin qytetar të tyre;
- Përdorë cigare dhe alkool në ambientet e shkollës;
- Përdorë drogë apo substanca të tjera që çënojnë figurën e tij në shkollë;
- Ketë kontakte dhe marrëdhënie të papërshtatshme me nxënësit;
- Përfshihet në dialog të papërshtatshëm me nxënësit përmes Internetit;
- Dërgojë tek nxënësit e-maile apo mesazheve me shkrim që kanë natyrë të papërshtatshme ose personale;
- Diskutojë me nxënësit për marrëdhëniet e veta personale e private;
- Ndërhyje ne menyre jo profesionale ne ceshtjet në çeshtjet e nxënësve
- Qëndrojë vetëm për vetëm me një nxënës në një situatë të izoluar ose private në rrethana të cilat janë ose mund të perceptohen si të një natyre të papërshtatshme.
- Krijojë, shikojë ose aksesojë imazhe të papërshtatshme të fëmijëve;
- Thyeje procedurat dhe udhëzimet e parapërcaktuara në rastin e veprimtarive të eskursioneve dhe udhëtimitve si dhe kërkesat shëndetësore dhe ato të sigurisë

që duhen në këto raste;

- Shpërdorojë çdo informacion sensitiv dhe personal për nxënësin dhe ta bëjë atë publik nëse një gjë e tillë nuk i kërkohet nga punëdhënësi ose nga ligji;
- Jape mesim famijes se tij.
- Inicioje, zhvilloje apo mbashtese asnjë veprimtari fetare, politike etj
- Marre masa disiplinore pa marre me pare aprovimin nga organet me te larta
- Te ndikohet nga persona jashte shkolles per vlerësimin e nxenesve me note
- Te vecoje nxenesit nga njeri-tjetri per shkak te cilësive te tyre
- Te nrije indiferent ne oren e mesimit
- Perdre nxenesin per arsye te veta personale apo familjare
- Te marre mase ekstreme ndaj nxenesit pa i dhene me pare atij mundesine e shpjegimit dhe mbrojtjes
- Nuk duhet t'i mbaje meri nxenesit per ceshtje thjesht personale
- Te vecoje nxenesit per shkak te pjesëmarrjes se tyre ne kurse private qe organizon vete mesuesi
- Te distancoje nxenesit per shkak te nivelit te te nrenit
- Te perdre telefonin celular ne oren e mesimit, ose te bisedoje me ndonje te afem ose koleg gjate zhvillimit te ores se mesimit
- Te ndikojne problemet personale te tij ne marrëdhëniet me nxenesit
- Të çënojë detyrimet profesionale lidhur me shpjegimin, komentimin, analizimin e sjarimin e informacionit që përçjell lënda që ai zhvillon
- Te nxise direkt ose indirekt nxenesit per t'i bere dhurata
- Te perdre pushtetin e notes per te krijuar autoritet
- Te shfaqet para nxenesve me nje panje dhe sjellje jo korrekte
- Krijojë frike e panik me sjelljen e tij ne klase e ambiente te tjera te shkolles

Rregullat e etikes ne marrëdhëniet  
mësues - drejtues

Mësuesit i kërkohet që :

- Te respektoje personalitetin e drejtuesit te tij ne pune dhe te zatoje kërkesat dhe udhëzimet e dhëna prej tij.
- Te jape kontributin e tij ,kur i kërkohet nga drejtuesi per shkak te mbarevajtjes se punes ne shkolle.
- Te mos e paragjkoje drejtuesin per shkak te prejardhjes, te gjinisë, te ngjyres, moshes etj.
- Te mos plotesoje dokumentacion apo te jape informacione te rreme.
- Te mos fyeje, ironizojë, pergojje, kërcënoje drejtuesin .
- Te mos beje akuza te pabazuara qe dëmtojne imazhin e drejtuesit.
- Te mos krijojë marrëdhënie intime me drejtuesin e tij.
- Te perdore ton normal komunikimi dhe te mos debatoje me drejtuesin ne ambiente te papërshtatshme (korridor, dorr), etj.
- Komunikimin me eproret ta beje ambiente zyre dhe jo ne prani te nxenesve ose kolegeve te tjere
- Te njoftojë me koha drejtuesin per problemet personale qe mund te pengojne procesin e mesimdhënie
- Te mos përpigjet te krijojë simpati tek drejtuesit nepermjet aferave korruptive
- Te zatoje me korrektesi dhe ne koha detyrat e ngarkuara nga eprori

Rregullat e etikes ne marrëdhëniet  
drejtues - mësues

Drejtuesit i kërkohet që :

- Te jete transparent, i ndershan i sakte dhe i drejte persa i perket informacionit qe u jep mesuesve dhe ne lidhje me mesuesit.
- Te mos kurseje ndihmen qe ofron institucioni ne raste te nevojshme per mesuesin
- Te mos diskriminoje mesuesit per

shkak te gjinise, ngjyres, kultures, moshes, profilit, bindjeve politike ose fetare.

- Te mos perdore tone te ashpra , fraza ironizuese apo fyerje ne komunikimin me mesuesit.

- Te mos beje publike informacione personale te mesuesit qe mund ta cenojne ate, por te trajtoje me respekt dhe konfidencialitet cdo informacion sensitiv dhe personal pamesuesin.

- Te mos perdore postin e tij per te ushtruar dhune psikologjike ndaj mesuesit

- Te mos krijoje diferencime midis mesuesve per arsye personale, por t'i trajtoje ne menyre te barabarte dhe me respekt ,ne perputhje me ligjin dhe pa dallim.

- Te mos nxise mesuesit per t'i dhene atij informacione per koleget.

- Te mos provokojë ,ngacmoje seksualisht apo te krijoje marrëdhënie intime me vartësit.

- Te mos kërkojë ( pranojë ) dhurata nga mesuesit per shkak te privilegjeve qe mund t'u krijoje ne pune.

- Te mos i shfrytëzojë dhe perdore mesuesit per interesa te veta personale.

- Të mos urdhërojë pjesëmarrjen e mësuesve në veprimtari politike, elektroale, fetare, etj.

- Te beje vlerësimin e punes se mesuesit ne menyre kolegjiale dhe transparente

- Te mos terheqe vëmendjen e mesuesit ne prani te nxënësve ose mjedise te papaershtatshme

- Te mos ushtrrojë dhune verbale dhe fizike ndaj mesuesit per shkak te pozicionit

Rregullat e etikes ne marrëdhëniet mësues - prind

Mësuesit nuk i lejohet të:

- Të shfrytëzojë prindin për interesa personale

- Të manipulojë prindin për të zhvilluar kurse mësimore private me fëmijën

- Ta detyrojë prindin për të investuar në shkollë pa dëshirën e tij

- T'u shesë prindërve produkte me natyre mësimore

- Të krijojë lidhje intime me prindin e nxënësit ne anëmbetë e shkolles

- Të përgojë e të kallzojë intimitete private e sekrete që lidhen me prindër e nxënës të tjerë që i janë mirënjohësuar prej tyre.

- Të injorojë idetë e prindit, rolin edukativ të tij apo kontribute në mbikqyrjen e punës së pavarur dhe në përkujdesjen prindërore.

- Të ngarkojë prindin me detyra që kërkojnë kualifikim pedagogjik.

- Të padite nxënësin tek prindi pa ushtruar më parë kompetencat e tij profesionale

- Të kategorizojë sjelljen negative të fëmijës dhe të fatalizojë korrigjimin e saj.

- Të merret me fëmijën dhe profilin e familjes në vend të trajtimit të ngjarjes konkrete.

- Të pengojë të shprehurit e prindit, me ndërhyrje, gjeste e lëvizje të pakontrolluara, të sulmojë prindin dhe ta krahasojë me të tjerët.

- Të ngrejë zërin, të humbë gjakftohësinë, të fyejë dhe të nxise konflikte te dhunshme.

- Të humbë mirësjelljen dhe autoritetin para prindit, të flasë me ton urdhëues, të diktojë mendime absolute dhe të mos marrë përgjegjësi, apo t'i japë prindit argumente dhe të përfundime logjike jo zyrtare gjatë komunikimit dhe të mos mbajë shënime duke shpërfillur vërejtjet dhe shqetësimet e tij.

- Të përdorë fjalor muge, të tyrosë duhan dhe të përdorë piqe alkolike gjatë komunikimit me prindin.

- Të injorojë figuren dhe rolin e kolegeve ne prani te prindit.

Rregullat e etikes ne marrëdhëniet mësues - mësues

Mësuesit nuk i lejohet:

- Të injorojë dhe shpërfillë rolin e kolegeve dhe bashkëpunimin me ta për arritjen e objektivave të mësimdhënies dhe edukimit.

- Të përgojë, të kërcënojë dhe të damaskojë në bisedat me te tjere aftësitë profesionale të kolegeve apo të dhëna rrebi jetën e tyre private.

- Të demostrojë para nxënësve marrëdhënie apo sjellje konfliktuale ndaj mësuesve.

- Të qëndrojë indiferent dhe i tërhequr në momente dhe situata kur një mësues keqtrajton, denigron një nxënës apo nuk vlerëson me objektivitet arritjet e tij.

- Të kërcënojë me përdorje një nxënës dhe të ndikojë tek mësuesit e tjerë për t'u imponuar opinionin e tij.

- Të krijojë e demostrojë marrëdhënie intime me kolegët brenda mjediseve te

shkolles.

- Të përdorë fjalor me fyerje, sharje, ironi apo shprehje denigruese.

- Të përdorë mjediset e shkolles për aktivitete qe sjellin përfitime personale.

- Të krijojë dhe të bëhet pjesë e klaneve dhe grupimeve që nxisin qejfribetje, urrejtje, egoizëm e cinizëm midis kolegeve

Rregullat e sjelljes jashtë institucionit arsimor

- Mesuesi duhet te demonstroje ne cdo mjedis standarte shembullore te sjelljes personale e profesionale ndersmerie dhe integriteti, ne menyre qe publiku i gjere te ketë besim tek ai dhe tek mesuesia si profesion.

- Sjellja e mesuesit ne jeten e perditshme personale, familjare dhe ne shqetisjet duhet te shërbejë si pike referimi per te afëmit dhe komunitetin ku ai jeton dhe punon.

- Mesuesi duhet te jete simbol i mbështetjes se marrëdhënieve qytetare ne cdo mjedis.

- Mesuesi duhet te jete mjohës i te drejtave, detyrave dhe përgjegjësive te tij ne cdo perballje me persona ose grupe personash te tjere.

- Mesuesit nuk i lejohet te perfshihet apo te perzihet ne diskutime, grindje dhe situatë te tjera te papaershtatshme per figuren dhe misionin e tij.

- Mesuesit nuk i lejohet te beje vepra imorale, te shfaqet ne gjendje te dëhur, ose te mbështete apo te kryej vete vepra te denueshme si vjedhja, perdorimi i drogës, etj.

- Mesuesit nuk i lejohet te mbaje arme zjari ose te fitcha.

Rregullat e veshjes

- Mesuesi ne shkolle dhe ne anëmbetë te tjera publike duhet te perdore veshje qe i pershtaten figures dhe misionit te tij si educator .

- Mesuesi duhet te jete shembull higjere e pastertie, te reflekttojë shije qytetare te perparuara dhe harmoni ne gjithë paraqitjen e tij te jashtme.

- Per figuren e mesuesit jane te papranueshme, sidomos ne mjediset e shkolles, veshjet estravagante, provokuese, perdorimi i bizhuterive te teparuara, ekspozimi i tatuazheve, minifundet, dëkoltet, etj.

Grupi i Punes

# Java e Veprimeve Globale për Arsimin 2008, (21-27 prill 2008)

Miliona njerëz do të mobilizohen për arsim cilësor, për t'i dhënë fund përjashtimit

## GLOBAL CAMPAIGN FOR EDUCATION

[www.campaignforeducation.org](http://www.campaignforeducation.org)

Është bërë traditë tashmë që çdo vit, javën e fundit të muajit prill, (sivjet është nga 21 deri 27 prill), të organizohet Java e Veprimeve Globale për Arsimin

Synimi i këtij aktiviteti të gjërë është që të mobilizojë opinionin publik për të ushtruar presion mbi qeveritë dhe agjensitë e tjera bashkëqeverisëse për të siguruar arsimin publik cilësor dhe falas për të gjithë. Ky aktivitet organizohet çdo vit, në të njëjtën periudhë, për të rikujtuar angazhimin e bërë nga 180 qeveri në Forumin Botëror të Arsimit organizuar në Dakar-Senegal, në prill të vitit 2000, në kontekstin e Qëllimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, (MDG), të Konbeve të Bashkuara, më të rëndësishmet ndër të cilat janë:

- Sigurim që deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët, veçanërisht vajzat, fëmijët në rrethana të vështira dhe ata që u përkasin minoriteteve etnike, të kenë akses në një arsim fillor falas, të detyueshëm dhe me cilësi të mirë.

- Arritje e 50 përqind përmirësime në nivelet e shkollimit të këndimit të të rriturve deri në vitin 2015, veçanërisht për gratë, dhe akses të paanshëm në arsimin bazë dhe, në vazhdim, për të gjithë të rriturit.

- Arritje e barazisë së gjinive në arsim deri në vitin 2015, duke u fokusuar në sigurim aksesit të plotë dhe të barabartë në të për vajzat dhe arritje të arsimimit bazë cilësor.

Sivjet është viti i nëntë i organizimit të Javës së Veprimeve Globale për Arsimin dhe historiku i pjesëmarrjes së njerëzve në aktivitetet e shkurtra të kësaj Jave nga njëri vit në tjetrin është në rritje të ndjeshme.

Një rekord prej 2 milion njerëz morën pjesë në aktivitetet e kësaj Jave në vitin 2003, të titulluar: "Arsimimi i Vajzave: leksioni më i madh".

Më shumë se 2 milion e gjysëm pjesëmarrës u regjistruan në aktivitetet e kësaj jave në vitin 2004, të titulluar: "Lobingu më i madh që ka ndodhur ndonjëherë në botë".

Rreth 5 milion pjesëmarrës u regjistruan në vitin 2005, në aktivitetet e kësaj Jave, të titulluar "Arsimimi që t'i japim fund varfërisë".

Më shumë se 5 milion e gjysëm pjesëmarrës u shënuan në aktivitetet e kësaj jave në vitin 2006, nën sloganin: "Çdo fëmijë ka nevojë për një mësues".

Po kaq pjesëmarrës morën pjesë në aktivitetet e kësaj Jave në vitin 2007, me pamullën: "Bashkohuni për të siguruar të drejtën për t'u arsimuar".

Këtë vit EI, në bashkëpunim me Fushatën Botërore për Arsimin, ka planifikuar Javën e Veprimeve Globale më të madhe të organizuar ndonjëherë, për të vazhduar përpjekjen mbarëbotërore për të siguruar Arsimin për të Gjithë brenda vitit 2015. Në mes të rrugës për afatin përfundimtar për qëllimet e EFA-s, Java e këtij viti është thelbësore. Aktivistët kudo po inçorohen për një javë të mbushur me aktivitete që do të bëjnë përmirësime në shkollat kudo në botë.

Tema për këtë vit është "Arsimimi Cilësor për të Gjithë, T'i japim fund përjashtimit, tani", duke qenë të ndërjegjeshëm që miliona njerëzve u ka munguar arsimimi cilësor për arsye të ndryshme. Rreth 72 milion fëmijë janë përjashtuar nga shkollimi dhe më shumë se 700 milion të rritur janë analfabetë në

nbarë botën. Disa përjashtohen për shkak të paftësisë ose gjinisë, të tjerë për shkak të konflikteve në vende të tjera, dhe më tepër, për shkak të varfërisë ose punës së fëmijëve. Cilado qoftë arsyeja, miliona fëmijëve po u mohohen të drejtat themelore dhe ne nuk mund ta pranojmë më këtë në mënyrë pasive.

Një ndër aktivitetet kryesore të Javës së Veprimeve Globale për këtë vit do të jetë Leksioni më i Madh i Botës, i cili do të mbahet në 23 prill 2008. Kjo është një ditë në të cilën qytetarët në nbarë botën do të bashkohen në klasë dhe do t'u mësojnë politikanëve, gazetarëve të mbarëbotës dhe liderëve një ndër leksionet më të rëndësishme që ata kanë marrë ndonjëherë. Leksioni do të mbahet mbi të drejtën për arsimim dhe mbi atë çka duhet bërë për të siguruar arsimim cilësor për të gjithë.

Fushata Botërore për Arsimim shprehon që këtë vit miliona njerëz do të marrin pjesë në këtë leksion dhe kjo konsiderohet si rekord për numrin më të madh të njerëzve që do të marrin pjesë në një leksion.

Në mënyrë që të arrihen qëllimet e arsimimit fillor universal brenda vitit 2015:

- Të gjithë fëmijët duhet të kenë filluar shkollën brenda vitit 2009; kjo do të thotë të regjistrohen 73 milion fëmijë me shumë vitin në vazhdim.

- 18 milion mësues në shumë nevojiten në nivel botëror, nëse çdo fëmijë do të ketë një arsimim cilësor.

- Për të qarë të gjithë fëmijët në shkollë do të kushtojë 9 miliardë USD në vit.

- Në mënyrë që fëmijët dhe të rriturit të marrin arsimimin cilësor që u është premtuar do të kushtojë 16 miliardë USD në vit.

Të gjitha vendet e G7, (Kanada, France, Gjermani, Itali, Japoni, Meksikë dhe Shtetet e Bashkuara), kanë ndihmë prej 5 miliardë USD e cila ishte premtuar. Kjo do të bëjë të mundur që 60 milion fëmijë të shkojnë në shkollë. (Kjo shumë prej 5 miliardë USD është e barabartë me shpenzimet e vendeve

Europiane për fermat bujqësore ose kostoja e katër aeroplanëve Stealth Bomber të Shteteve të Bashkuara).

Në vitin 2007 tetë vendet më të pasur në botë prentuan një shtesë prej 500 milion USD për planet mbi arsimimin në vendet e varfëra, gjë që duhet të vihet në praktikë.

Një pjesëmarrje masive pritet në aktivitetet që do të zhvillohen në kuadrin e kësaj Jave edhe vendin tonë. Përgatitjet kanë kohë që kanë filluar. Ato mbështeten edhe këtë vit nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, e cila vazhdon të jetë shumë aktive për këtë çështje. Duke qenë se në fushën e arsimit dhe të mbrojtjes së fëmijëve janë të angazhuara edhe disa organizata e institucione të tjera, të cilat janë aktive gjatë ditëve të Javës së Veprimeve Globale, edhe këtë vit vazhdon të funksionojë Kolacioni, me pjesëmarrjen e Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, (CRCA), dy sindikatave të arsimit, FSASH e SPASH, World Vision Albania, UNICEF, Save the Children, IRCCRA, Qendra "Vatra", Shkolla "SOS Fshatrat e Fëmijëve", QIKA, MEDPAK, etj, i cili po ndjek nga afër organizimin e shumë aktiviteteve, ndër të cilat mund të përmendim: një Konferencë të përbashkët për shtyp, e cila pritet të zhvillohet në datën 21 prill, një Takim koordinues me gazetarët pjesëmarrës në Fushatë, një takim i përbashkët i FSASH e SPASH, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, me pjesëmarrjen e mësuesve e nxënësve, kryesisht nga rrethi i Tiranës, disa takime të seksioneve sindikale të FSASH e SPASH në rrethet kryesore, etj.

Për veprimtaritë e kësaj Jave janë përgatitur postera nga Kolacioni, të cilët së bashku me ato që kanë mbërritur tashmë nga EI, po shpërndahen në seksione e shkolla, për t'u ekspozuar e për të propaganduar synimet e kësaj Jave.

Seksionet sindikale në rrethe dhe këshillat sindikale në shkolla, në bashkëpunim me përfaqësuesit e këtyre organizatave dhe Drejtoritë Arsimore në qarqe e rrethe, ashtu si edhe të gjitha shoqatat pjesëmarrëse në Koalicion, do të organizojnë, gjithashtu, aktivitete të rëndësishme në shkolla e në nivele të tjera, duke u përqendruar sidomos tek Leksioni më i Madh i Botës, i cili do të mbahet në 23 prill 2008, ora 09.00.

Përgatiti  
Stavri LIKO

## Mbi reformen e sistemit te zhvillimit profesional te mesuesve

(Vijon nga numri i kaluar)

### MENTORI

Gjatë periudhës së licencimit, mësuesi-fillestar ndihmohet nga një mësues i një shkalle më të lartë të karrierës (Mentori).

Si rregull, Mentori është mësues i po asaj shkolle.

Përgatitja e mësuesit fillestar për të marrë titullin "mësues" shkon përtej asistencës së Mentorit. Ai është i detyruar të ndjekë një program trajnimi që përbëhet nga disa module dhe duhet të sigurojë pikët e mjaftueshme për këto module.

Mentori dhe mësuesi-fillestar kryejnë vizita sistematike të ndërsjellta në orët mësimore të njeri-tjetrit, gjithashtu mësuesi-fillestar kryen vizita te mësues të tjerë të asaj shkolle ose të shkollave të tjera.

Kompetenca e Mentorit fuqizohet me anën e trajnimeve të posaçme dhe manualit për mentorët.

Koha e ndihmës për mësuesin fillestar përfshihet në normën mësimore të mësuesit-mentor.

Mentori mund t'i rezervojë mësuesit-fillestar pak orë nga ngarkesa e tij mësimore.

Mentori mund të jetë me kohë të pjesshme ose të plotë, për një periudhë e cila parashikohet në kontratën që DAR\ZA bashkëndëshkruan me të.

Mësuesi-mentor paguhet më shumë se mësuesi i po asaj shkalle të karrierës për orë mësimore ose ka një normë më të ulët mësimore.

Mentori plotëson paketën e monitorimit dhe vlerësimit të mësuesit-fillestar, pëmbajtja e të cilit është e standardizuar.

Mentori i paraqet nëndrejtorit pedagogjik të shkollës një raport me të cilin argumenton propozimin e tij për përfundimin ose shtyrjen e periudhës së licencës.

\*\*\*

Në rastin kur Mentori propozon përfundimin e licencës, nëndrejtori

pedagogjik shkruan raportin me të cilin miraton propozimin e mentorit ose e hedh poshtë atë.

Kur Mentori dhe drejtorja e shkollës miratojnë përfundimin e licencës, drejtori paraqet dokumentacionin e miratimit tek DAR\ZA përkatëse.

DAR\ZA përkatëse shqyrton plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit dhe kur e gjen të vlefshme, njofton Sektorin e Burimeve Njerëzore në MASH, i cili përgatit dokumentin përkatës.

### KREDITET (PIKËT)

Një mësues e fiton një titull të karrierës nëse pëmbush standardet e atij titulli.

Standardet e një titulli përbëhen nga standardet e:

Mësuesit në përgjithësi;

Mësuesit lëndor ose fushë lëndore.

Që mësuesi të fitojë një shkallë (përveç shkallës së parë, pas licencës) duhet të:

Ketë një fond minimal pjesëmarrjeje në trajnime (P.sh. një numër minimal seancash trajnuese)

Grumbullojë një numër minimal pikësh (kreditesh) (Pikë të fituara falë njohurive dhe performancës së mësuesit)

Shuma e duhur e pikëve për një shkallë të karrierës përbëhet nga:

pjesa e pikëve për njohuri teorike,

pjesa e pikëve për aftësi praktike në zhvillimin e mësimit,

pjesa e pikëve për arritjet e nxënësve,

pjesa shtesë e pikëve (p.sh. parashikohet një sasi pikësh për mësuesin që fiton një vlerësim onorifik në nivel lokal ose kombëtar si "Më i miri në buletin e përvojave të përparura", etj)

### PAKETA PROFESIONALE E MËSUESIT

Në mënyrë të shkallëve të karrierës, mësuesi plotëson paketën e tij  
Vijon në faqen 14

Vijon nga faqja 13

profesional, si kusht paraprak për t'u pranuar në veprimtaritë e marrjes së titullit.

Paketa përmban dëshmi zyrtare.

Dëshmi të tilla janë:

CV e tij,

Vlerësimet periodike për mësuesin nga nëndrejtori pedagogjik ose inspektorët,

Certifikatat e pjesëmarrjes në trajnime,

Shënime nga vëzhgimet zyrtare të arëve të tij mësimore,

Arritje të nxënësve të tij në vlerësimet e jashtme standarde,

Fitues të nxënësve të tij në olimpiadat lokale ose kombëtare,

Vlerësime për punën si mësues nga drejtoria e shkollës, ku një zë i posaçëm është për etikën e mësuesit,

Vlerësime nga anketat shkollore me nxënës ose prindër,

Nderime nga organizma të ndryshme,

Arritjet "bonus" profesionale, si

masteri, shkrime ose kumtesa (tema kërkimore)<sup>1</sup> ose botime, etj.,

Roste profesionale si kryetar i ekipit lëndor, etj;

Dëshmi të pjesëmarrjes në takime profesionale lokale, kombëtare ose jashtë shtetit,

Botime (shkrime profesionale te gazeta "Mësuesi", " Tribuna Sindikale", botime te institucioneve vartëse të Ministrisë, botime të QJF-ve, kontribute në revista, në faqen e internetit, botime të DAR, etj),

Fitim projektesh qeveritare ose joqeveritare;

Qmimë për konkurse qeveritare ose joqeveritare;

Anëtarësimi në organizatat sindikale të mësuesve, etj.

Paketa përbëhet nga dy pjesë:

Pjesa e standardizuar, ku paraqiten dëshmi sipas një liste standarde kërkesash;

Pjesa "e lirë", ku mësuesi shton dëshmi të vetat, por sipas një "menuje" të standardizuar.

Paketa, që plotësohet nga mësuesi, përbëhet nga disa seksione.

Këto janë:

Njohuritë (shkencore të lëndës dhe shkencore të didaktikës),

Shprehitë (zbatimi i njohurive në procesin mësimor),

Arritjet e nxënësve,

Kontributi i mësuesit ndaj kolegëve të shkollës,

Kontributi i mësuesit ndaj kolegëve në përgjithësi.

Paketa e mësuesit përmban një seksion të veçantë me dëshmi zyrtare të drejtorit të shkollës për ndëshkimet në fuqi të mësuesit si: Vërejtjet me shkrim sipas Dispozitave Normative; heqje e një roli profesional.

Këtë seksion e plotëson drejtori i shkollës.

(Vijon ne numrin e ardhshëm)

<sup>1</sup> Mund të porositet një listë temash kërkimore, sipas politikave të MASH-it ose DAR-it, madje të ketë një konkurs vjetor për to.

## GEZUAR LIRINE, KOSOVA MARTIRE

Ra perçja, tragjedia mbaroi. Sa gjatë, sa e trishtueshme!

Një shekull prologu me epilogun. Nuk i pati shkuar ndër mend një tragjedi e tillë as Shespirit, jo më te ishte një realitet. Si do të ishte zgjidhja? Pacifizmi apo violenca?

Hesht i zhgënjyer Rugova që u shua për paqen. Nuk ishte gabim në kohë. As faj nuk pati se ishte përfaqësues i një populli pacifist. Shekulli XXI. Shuhet familja Jashari. Në domrin e shtëpisë së tij u vra plaku pjesëmarrës i dy luftërave botërore, pati mbajtur anën e progresit. Në atohun e pronën e tij ishte. Edhe rrezet e diellit me të cilat po ngruhej vetvetiu ranë, nuk i grabiti. U ngritje intelektual i Ushin Hoti. Pati trajtuar nbi baza filozofike çështjen e krahut të vet. U gozhdua si Krishti, përfundoi në furrën e druve, u lëshua në humnerë, apo ...?!

Imponohet violence. Mbaroi durimi i shtërgjatur. Nuk durojmë më as përtej Paqësorit. Por tashmë nuk hesht as Kontinenti i vjetër.

Ku shkon kalorës i mesjetës?! Asgjë s'paska mësuar nga historia. Si shuhen popujt që kanë ruajtur gjuhën, kulturën, doket.. Aq më tepër kur u përkasin krahëve të vjetra të Planetit. Natyrisht quhen martir, kur sakrifikojnë shumë për mbijetesë.

Dhe liria erchi. Durimi, sakrifica, heroizmi u mbulua me lavdi. Prishtina, ku mediat informojnë të gjitha pikat e Globit për gjithshka ndodh, dhuron edhe emocione, shpërndan edhe energji. Big Bang i Tokës për 24 orë.

Duket si vend pelegrinazhi. V isitor nga të gjitha koordinatat e Planetit po shkojnë e do të shkojnë për të parë sa shtrenjtë ka kushtuar liria.

Në rëkohë që pata qenë i detyruar nga ta ndiqja këtë ngjarje madhështore,

që e kishin ëndëruar breza të tërë shqiptarësh, u binda se duke kapur çdo detaj nga kanalet e ndryshme televizive, kisha bërë zgjedhjen e duhur. Planeti ynë, Toka ishte veshur me flamurin shqiptar. Me të njëjtën amplitudë me flamurin e Prishtinës lëkundej flamuri në sheshin Skënderbej, me flamurin e pafund të Prizrenit, me flamurin në Pajtonin e Ismail Qemalit në Vlorë, me flamurin e kalasë "Rozafa" të Shkodrës...

Kosovë: sa ankth kemi përjetuar, sa emocione na dhurove. Faleminderit për gjithshka ke bërë. Atynisi, atynbaroi. S'ka si bëhet më kukur. S'më mbetet gjë tjetër veçse t'i bashkohem urimit të të gjithëve: "Gëzuar lirinë Kosova martire"!

Udhë të mbarë drejt stacionit ku bashkohen kulturat e qytetërimit!

Isa Reka  
Shkoder

## Të reja shkencore

### FIBËR FLEKSIBËL

Kabllo me fibër optike duhet të qëndrojë tërësisht të tendosura që të



transmetojnë një sinjal të fortë, kështu, është e vështirë dhe e shtrenjtë për t'u instaluar në apartamente. ClearCurve e ka zgjidhur këtë ngërç duke shtuar një "gardh" mbrojtës rrotull bërthamës së hollë prej xhami të kablilit në mënyrë që të përkulë, të rrotullojë dhe të kthejë telin në cepa

të çfarëdollojshëm pa prishur lidhjen. Ky zbulim ka bërë që shumë kompani që ofrojnë shërbimin e internetit dhe telefonisë dhe që ata që duan të shpërndajnë sinjalin në adresa të reja të kërcejnë nga gëzimi.

### HIQE NGA PRIZA

Kur flitet për të shkuar drejt shërbimeve pa fill, (wireless),



zakonisht bëhet fjalë për llojet e telave që bëjnë lidhje për të dhëna dhe informacione. Por, nëse do të mundeni të karikoni pajisjet tuaja pa patur nevojë për korent? Kjo fantazi u bë realitet në 2007 me pajisje si

WildCharger "tryezë" karikimi. Është e përshtatshme për celularin tuaj duke përdorur një adaptor. Vendose në "tryezë" dhe ai do të marrë karikim menjëherë, aq shpejt sa do të bënte edhe po të përdornit mënyrën tradicionale të karikimit, me energji elektrike.

### BIG AUDIO

Pse të blesh një system të përbërë nga gjashtë pjesë kur ka një kuti të vetme që bën punën e të gjashtëve? Yamaha YSP-3000 (\$1200) shpërndan një tingull surround të mahnitshëm pa



patur nevojë për një marrës të veçantë ose subwoofer. Është aq e vogël, sa mund të qëndrojë në një raft me televizorin tuaj. Doni më? Ajo përfshin edhe një DVD (lexues) të fshehur boshtë panelit të përparmë.

## LOFTË NË VENDIN E PUNËS

*Për shumë njerëz java e punës është më e gjatë se 40 orët tradicionale. Dreka pune dhe detyra të orëve të vona mund t'ju mbajnë në zyrë.*

*Çuditëni tani pse ka mosmarrëveshje në vendin e punës?*

*Ndonjëherë nuk ka rëndësi sa të gatshëm jeni të injoroni problemin, thjesht nuk mundeni.*

### Pala tjetër: Një koleg

**Lufta:** Mosmarrëveshjet me kolegët janë gjithçka përveç se të rralla. Ka shumë mundësi që të shpenzoni më shumë kohë duke bashkëpunuar me kolegët se me këdo tjetër. Natyra njerëzore sugjeron se dikur do të irritoheni me njëri tjetër. Faktor nxitës është konkurrenca për ngritjen në detyrë dhe vëmendjet e shefit tuaj. Kjo është receta e duhur për të patur konflikt me një koleg tuajin.

**Zgjidhja:** Fillimisht mendohuni pak për të planifikuar planin tuaj të veprimit. Emocionet duhet t'i nxirni jashtë ekuacionit dhe sigurohuni që po silleni në mënyrë aktive dhe jo pezmatuese. Organizoni një takim dhe mbani një axhendë gati, në mënyrë që të jeni konstruktivë dhe të përqëndruar. Qëllimi i takimit duhet të jetë "diskutim mbi mënyrën si të punoni me më shumë efektivitet si skuadër dhe diskutim

mbi çështje që mund të shfaqin pengesa në të ardhmen".

### Pala tjetër: Shefi juaj

**Lufta:** Mirë, po luftoni me shefin dhe kjo gjë nuk është asnjëherë e mirë. Shumë çështje ndikojnë në të, është thjesht një ndryshim në ide apo politike zyre. Edhe nëse nuk keni punë me shefin tuaj përditë tek e tek, ai ose ajo ndikon në detyrat tuaja të përditshme dhe të ardhmen tuaj në kompani. Është shumë e vështirë të vendosësh si të mbrosh veten pa qenë nevoja të mblidhni menjëherë gjerat tuaja dhe të shoqërohni jashtë nga rojet e sigurisë.

**Zgjidhja:** Një shef i mirë do t'ju angazhojë në dialog për shqetësimet që mund të keni. Organizoni një takim për të folur për ato që ju shqetësojnë. Asnjërit nuk i pëlqen të ketë rezultate të dobëta, veçanërisht supervizorit tuaj. Fokusohuni në mënyrën si shqetësimet tuaja ndikojnë në produktivitetin dhe mjedisin në punë. Qëllimi juaj kryesor duhet të jetë të përmirësoni procese ose çështje brenda kompanisë.

### Pala tjetër: Një klient

**Lufta:** Nëse merreni me klientë dhe shitës çdo ditë është e sigurt që do të irritoheni nga diçka që ata bëjnë. Ndoshta ata janë të shtresave të

ndryshme, ose janë shumë kokëfortë për t'ju dëgjuar. Cilido qoftë rasti, duhet të dini të menaxhoni situatën.

**Zgjidhja:** Sa e ndërlikuar mund të jetë të diskutosh me shefin për një shqetësim, akoma edhe më e vështirë të hapësh këtë temë me klientët që ju japin punë. Në fakt duhet të siguroheni që ka arritur çështja aty ku nuk mund të anashkaloni më para se të vendosni të diskutoni me ta.

Nëse diskutimi është diçka që do të rrisë prodhimin në punë ose do të rregullojë marrëdhëniet, atëherë bisedimi duhet të ndodhë herët a vonë. Nëse bëhet fjalë thjesht për një përplasje karakteresh kalimtare dhe jo për një çështje thelbësore në punë, vini në përdorim logjikën dhe mendoni nëse ia vlen të diskutohet kjo temë apo jo.

Pavarësisht me kë keni marrëdhënie, mbani mend që jeni ju ata që vendosni cilat janë limitet tuaja. Nëse vazhdimi i heshtjes shton stresin tuaj në vend që ta ulë atë, atëherë duhet të flisni. Nëse ndodhëni në një ambient ku asgjë nuk ndryshon ose shqetësimet tuaja nuk i adresohen askujt, mendoni nëse është një vend i mirë për ju apo jo.

# TRIBUNA SINDIKALE

